

# TRASHËGIMIA KULTURORE NË

# FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHqipëri

TRASHËGIMIA  
KULTURORE NË  
FO  
KU  
S.



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE  
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE  
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

**Titulli:** “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

**Përkthimet nga origjinali:** Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

**Redaktoi:** Boiken Abazi

**Parathënie për botimin nga:** Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

**Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:**

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

**Foto:** © Bjori Thana, Regina Vathi

**Dizajni:** Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

**ISBN: 9789928801081**

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

**Shtëpia Botuese:** “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

# DEKLARATA E ICOMOS-IT NË SHËNIMIN E 50-VJETORIT TË DEKLARATËS UNIVERSALE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Stokholm, 11 shtator 1998.

## ICOMOS

Përkthyer nga: Sonila Kora  
Redaktuar nga: Boiken Abazi

Versioni origjinal ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

Në takimin e mbajtur në Stokholm, ICOMOS-i dëshiron të theksojë rëndësinë e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila në vitin 1998 kremton 50-vjetorin e saj, dhe në mënyrë të veçantë njohjen e të drejtës së çdokujt për të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të komunitetit.

Përveç rëndësisë së konventave apo legjislacionit specifik në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen e saj, duke marrë parasysh natyrën e pazëvendësueshme të trashëgimisë materiale dhe jomateriale (të prekshme dhe të paprekshme) dhe pozitën e kërcënuar të saj në një botë në transformim të vazhdueshëm, ICOMOS-i pohon se e drejta për trashëgiminë kulturore është pjesë përbërëse e të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë bart detyra dhe përgjegjësi për individët dhe komunitetet si dhe për institucionet dhe shtetet.

Mbrojtja e kësaj të drejte sot nënkupton ruajtjen e të drejtave të brezave të ardhshëm.

- *E drejta për të pasur dëshmi autentike të trashëgimisë kulturore, që respektohet si shprehje e identitetit kulturor brenda familjes njerëzore;*
- *E drejta e çdokujt për të kuptuar më mirë trashëgiminë e vet dhe atë të të tjerëve;*
- *E drejta për të përdorur trashëgiminë me mençuri dhe në mënyrën e duhur;*
- *E drejta për të marrë pjesë në vendimet që ndikojnë mbi trashëgiminë dhe vlerat kulturore që ajo mishëron;*
- *E drejta për të krijuar shoqata për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.*

Këto janë të drejta që ICOMOS-i beson se duhet të respektohen për të ruajtur dhe pasuruar larminë kulturore të botës.

Këto të drejta nënkuptojnë nevojën për të njohur, vlerësuar dhe mirëmbajtur trashëgiminë, si dhe për të përmirësuar dhe zbatuar një kuadër veprimi. Ato nënkuptojnë strategji zhvillimore të përshtatshme dhe partneritet të barabartë mes shoqërisë, sektorit privat dhe individëve për të harmonizuar interesat që ndikojnë mbi trashëgiminë kulturore si dhe për një ekuilibër pajtues mes mbrojtjes së trashëgimisë dhe zhvillimit. Në frymën jetësuese të këtyre deklaratave, ato bëjnë thirrje për bashkëpunim ndërkombëtar në lidhje me konventat, legjislacionin dhe masat e tjera statutore.

Këto janë përgjegjësi të përbashkëta që duhen ndarë mes të gjithëve (individualisht dhe kolektivisht), ashtu siç ndajnë të gjithë pasurinë që na transmeton kujtesa, në kërkim të një zhvillimi të qëndrueshëm në shërbim të Njerëzimit.